



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES

Nr. 806/4 prot.

Tiranë, më 18.12.2024

V E N D I M

Nr. 79, datë 18.12.2024

PËR

**VERIFIKIMIN E LIGJSHMËRISË SË VEPRIMEVE ADMINISTRATIVE TË
KRYERA NGA ORGANI I DISIPLINËS, I NGRITUR PRANË DREJTORISË SË
PËRGJITHSHME TË TATIMEVE GJATË ZHVILLIMIT TË PROCEDURËS PËR
DHËNIEN E MASËS DISIPLINORE NË NGARKIM TË NËPUNËSIT CIVIL**

*****.

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të verifikimit të veprimeve administrative të kryera nga organi i disiplinës gjatë procesit disiplinor në ngarkim të nëpunësit civil *****,

VËREJ SE:

Pranë Komisionerit ka ardhur informacioni i regjistruar me nr. 806 prot., datë 31.10.2024, i dërguar nga nëpunësi ***** me detyrë “Përgjegjës Sektori i Kontrollit në Vend sipas Industrive, në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj, në Drejtorinë Rajonale Tiranë”, në përmbajtjen e të cilit janë ngritur pretendime për shkelje të hapur të ligjit për shërbimin civil nga ana e Komisionit Disiplinor që funksionon pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, gjatë zhvillimit të procesit disiplinor në ngarkim të nëpunësit civil *****. Rezulton se ky procedim disiplinor

është përbyllur me Vendimin nr.129, datë 13.3.2024, të Komisionit të Disiplinës, me të cilin është vendosur largimi nga shërbimi civil i nëpunësit në fjalë.

Pasi Komisioneri është njohur me këtë informacion, përmes shkresës nr. 806/1 prot., datë 04.11.2024, ka kërkuar nga institucioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të dërgojë të gjitha aktet administrative që materializojnë procesin disiplinor të zhvilluar në ngarkim të nëpunësit *****. Nëpërmjet shkresës nr.18504/1 prot, datë 15.11.2024, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka përcjellë pranë Komisionerit dokumentacionin e kërkuar, me qëllim që të mundësohet realizimi i një hetimi të plotë administrativ për këtë rast.

Nga analiza e këtij dokumentacioni, rezulton se, nëpunësi ***** gëzon statusin e nëpunësit civil në pozicionin e punës “Përgjegjës i Sektorit të Kontrollit në Vend sipas Industrive, në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj, në Drejtorinë Rajonale Tiranë”, i klasifikuar në kategorinë e ulët drejtuese, në sistemin e shërbimit civil.

Ndërkohë, konstatohet se përmes aktit nr. 54, datë 05.08.2020, “Për caktimin e një nëpunësi për ushtrim të përkohshëm të funksioneve”, të nxjerrë nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, ky nëpunës është urdhëruar të ushtrrojë përkohësisht edhe detyrat funksionale të Drejtorit të Drejtorisë Rajonale Tiranë, funksion i cili është dy nivele më lart se pozicioni i fituar ligjërisht nga nëpunësi ***** , sipas parashikimeve të nenit 19 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Shkak për të filluar ecuria disiplinore për punonjësin në fjalë, është bërë një kontroll i ushtruar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit (në vijim KLSH), në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë, i materializuar nëpërmjet kërkesës me nr. 1247/54 prot, datë 30.09.2022, ku janë evidentuar shkelje shumë të rënda të Rregullores së Funksionimit të Administratës Tatimore, (akt i miratuar me urdhrin nr. 192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë), të kryera nga nëpunësi ***** në momentin kur ushtronte përkohësisht detyrat e Drejtorit Rajonal.

Më konkretisht, shkeljet janë evidentuar si probleme të konstatuara gjatë zbatimit të pikave 3, 10, 11, 18, 20 të nenit 4, të Rregullores së Funksionimit të Administratës Rajonale Tatimore, që kanë të bëjnë kryesisht me:

- ✓ Parregullsi në kontrollet e ushtruara pranë subjekteve: “Amfora” shpk, “Klejvi An” shpk, “Gulit” shpk, “Sanel” shpk, “United Capital Ventures” shpk, “Arisa Konfeksion” shpk, “FBD” shpk, “Shimani” shpk, “HEC-i Dragostonja” shpk;
- ✓ Përgjegjësi për menaxhimin e burimeve njerëzore sipas nenit 4/3 të Rregullores;

- ✓ Referuar regjistrin të akt-marrëveshjeve të DRT Tiranë, për periudhën 01.01.2021 - 31.10.2021, nuk është zbatuar pika 10, e Udhëzuesit të Përgjithshëm të Procedurave për Mbledhjen me Forcë, datë 15.03.2018, si dhe të Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008, “Për Procedurat Tatimore në RSH”, pasi është përdorur akt-marrëveshja si mënyrë për të moskaluar në masa shtrënguese për të mbledhur borxhin tatimor;
- ✓ Në lidhje me zbatimin e planit operacional për periudhën Korrik-Dhjetor 2020, nëpunësi ***** në cilësinë e Drejtorit të DRT Tiranë ka raportuar në mënyrë fiktive të dhënat të cilat nuk janë reale;
- ✓ Nuk janë respektuar të drejtat e tatimpaguesve sipas neneve 30-38, 83, të Kodit të Procedurave Tatimore;
- ✓ Nuk janë zbatuar detyrimet e manualit mbi çështjet në sistemin informatik.

Pasi u njoh me gjetjet e grupit auditues të KLSH, titullari i institucionit përmes urdhrit nr. 17926 prot., datë 19.10.2022, “Për ngritjen e Komisionit Disiplinor”, ka ngritur Komisionin Disiplinor (në vijim KD) dhe ka vënë në administrim të tij aktin nr. 1247/54 prot, datë 30.09.2022, të KLSH dhe shkresën nr. 746/10 prot, datë 06.10.2022, të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor të DPT, ku evidentohen përgjegjësitë e nëpunësit ***** , gjatë ushtrimit të përkohshëm të detyrave funksionale të Drejtorit të Drejtorisë Rajonale Tiranë.

Pasi u njoh me këto akte, KD vlerësoi se, referuar nenit 59/2, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, ka kompetencë të plotë lëndore për shqyrtimin e pretendimeve të ngritura nga KLSH dhe nga Drejtoria e Kontrollit Tatimor e DPT, pasi pretendoheshin shkrelje shumë të rënda të detyrave të kryera nga nëpunësi në fjalë.

Me shkresën nr. 16895/3 prot., datë 21.10.2022, të KD është njoftuar nëpunësi Gj.Duro për fillimin e ecurisë disiplinore si dhe për zhvillimin e seancës dëgjimore pranë ambjenteve të DPT-së, në datën 27.10.2022, ora 10.00.

Takimi nuk u zhvillua në datën 27.10.2022, por në datën 03.11.2022, sepse nëpunësi i proceduar kishte paraqitur raport mjekësor. Në këtë takim KD, në prezencë të nëpunësit civil, ka parashtruar shkeljet e konstatuara nga KLSH në procesin e auditimit të kryer pranë DRT Tiranë, si dhe ato të parashtruara në shkresën nr. 746/10 prot, datë 06.10.2022, të cilat kishin shërbyer për fillimin e procedimit disiplinor. Gjatë seancës është marrë në pyetje nëpunësi civil në procedim dhe më tej KD ka vendosur:

“.. që hetimi administrativ për shkeljet e konstatuara ndaj ***** për marrjen e vendimit përfundimtar në përfundim të shqyrtimit disiplinor të nisur ndaj tij, të vazhdojë në

datën 13.12.2022, për t'i dhënë mundësinë dhe kohën e nevojshme anëtarëve të KD të njihen me materialet dhe provat shkresore të administruara”.

Në datën 13.12.2022, është zhvilluar seanca e radhës me pjesëmarrjen e nëpunësit civil dhe KD, referuar nenit 66 dhe 67, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative” vendosi:

*“Pezullimin e procedurës administrative për ecurinë disiplinore nr.16895/3 prot., datë 21.10.2022, ndaj ***** me detyrë “Përgjegjës në Sektorin e Kontrollit në Vend Sipas Industrive, në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj, në Drejtorinë Rajonale Tiranë (caktuar të ushtrojë përkohësisht detyrat funksionale si përgjegjës sektori në Drejtorinë për proceset e Biznesit) gjatë kohës që ka ushtruar funksionet e Drejtorit Rajonal në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë, deri në përfundimin e hetimit nga Drejtoria e Investigimit të Brendshëm (Antikorrupsion) në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”.*

Referuar procesverbalit nr.83/2, procesi disiplinor në ngarkim të nëpunësit ***** ka rifilluar në datën 05.1.2024 (pra, pas 14 muajve pezullim) dhe në këtë seancë, KD ka vënë në dispozicion të nëpunësit civil në procedim, shkresën nr. 21065/1 prot., datë 28.12.2023, të dërguar nga Drejtori i Drejtorisë së Investigimit të Brendshëm Antikorrupsion në DPT, përmes të cilës **ishin parashtruar shkelje të reja të cilat nuk ishin në objektin e procedimit disiplinor që po zhvillohej** dhe njëkohësisht ka shtyrë seancën për në datën 09.01.2024.

Më tej, rezulton se përmes Vendimit të Ndërmjetëm nr. 6, datë 09.01.2024, KD ka vendosur zgjatjen e afatit për përfundimin e shqyrtimit të procesit disiplinor me 60 ditë, për t'i mundësuar nëpunësit të njihet me shkeljet e reja të konstatuara nga Drejtoria e Investigimit të Brendshëm (Antikorrupsion) në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

Seanca e fundit dëgjimore është zhvilluar në datën 12.03.2024, në të cilën KD ka marë Vendimin Përfundimtar të procesit disiplinor përmes të cilit është vendosur largimi nga shërbimi civil i nëpunësit *****. Ky vendim i arsyetuar është regjistruar me nr.129, në datën 13.3.2024 dhe po në të njëjtën ditë i është komunikuar edhe nëpunësit.

Në zbatim të Vendimit nr.129, datën 13.03.2024, të KD, ka dalë akti nr. 2089/2 prot., datë 03.04.2024, i Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, përmes të cilit është urdhëruar ndërprerja e marrëdhënieve financiare për nëpunësin ***** dhe dorëzimi i detyrës prej tij.

Nga analiza e dokumentacionit të administruar nga ana e Komisionerit (i cituar edhe më sipër) rezulton se procedimi disiplinor ndaj nëpunësit ***** ka filluar për shkak të konstatimit të shkeljes së rëndë të detyrës, në kohën kur ky nëpunës ka ushtruar përkohësisht funksionet e Drejtorit të DRT.

Për këtë shkak, Komisioneri vlerëson të rëndësishëm verifikimin e ligjshmërisë së aktit nr. 54, datë 5.8.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, përmes të cilit i janë ngarkuar një nëpunësi të nivelit të ulët drejtues, (*pasi nëpunësi ***** ishte i emëruar “Përgjegjës Sektori i Kontrollit në Vend sipas Industrive, në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj, në Drejtorinë Rajonale Tiranë”*) të ushtronte përkohësisht funksionet e Drejtorit të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë.

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” në pikën 2, germa “a”, nënpika “iv”, të nenit 99, kërkon që akti administrativ të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën është mbështetur organi publik për nxjerrjen e tij.

Nisur nga përmbajtja e aktit administrativ nr. 54, datë 05.08.2020, “Për caktimin e një nëpunësi për ushtrim të përkohshëm të funksioneve”, rezulton se **në të nuk është evidentuar dispozita ligjore** mbi të cilin është mbështetur institucioni i DPT, për caktimin e një nëpunësi në ushtrimin e përkohshëm të funksioneve.

Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë ka parashikuar vetëm delegimin e funksioneve nga një institucion në tjetrin dhe jo delegimin e detyrave.

Nga ana tjetër, në nenet 12/2 dhe 13/3,4, të ligjit nr. 90/2012, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore”, është përcaktuar shprehimisht se:

Neni 12/2 “Sektorët”

.....

2. *Sektori drejtohet nga shefi i sektorit, i cili i raporton drejtpërdrejt drejtorit të drejtorisë, pjesë e së cilës është sektori. **Shefi i sektorit, në rast mungese apo paaftësie afatshkurtër, zëvendësohet, për shkak të ligjit, nga nëpunësi civil i nivelit më të lartë të të njëjtit sektor.** Në rast se ka më shumë se një nëpunës civil të të njëjtit nivel, ai zëvendësohet nga nëpunësi civil i nivelit më të lartë që ka vjetërsi më të madhe në shërbimin civil.*

Neni 13 “Drejtoritë”

....

2. *Drejtoria drejtohet nga drejtori. Përveç kur parashikohet sipas ligjit, drejtori i raporton drejtorit të përgjithshëm ose drejtorit të departamentit, pjesë e të cilit është drejtoria...*

4. ***Pika 2 e nenit 12 të këtij ligji zbatohet, me ndryshimet përkatëse, për zëvendësimin e drejtorit.***

Referuar dispozitave të sipërcituara, zëvendësimi i Drejtorit të Drejtorisë në rast mungese apo paaftësie afatshkurtër, realizohet për shkak të ligjit, **nga nëpunësi civil i nivelit më të**

lartë. Po në të njëjtën mënyrë zëvendësohen edhe Drejtorët e Departamenteve apo Drejtorët e Përgjithshëm.

Duke u kthyer në rastin konkret, rezulton se DPT ka urdhëruar në shkelje të hapur të ligjit zëvendësimin e Drejtorit të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë me një nëpunës të kategorisë së ulët drejtuese, i cili ishte dy kategori më poshtë në hierarkinë administrative, duke pasur si epror direkt drejtorinin e drejtorisë, i cili kishte epror direkt Drejtorin Rajonal.

Ndërkohë, referuar dispozitave të sipërcituara zëvendësimi i përkoshëm realizohet **vetëm nga një nëpunës i një kategorie më të lartë se ajo që mban nëpunësi që po zëvendësohet**. Vlen të theksojmë se ligji parasheh zëvendësimet për një periudhë afatshkurtër dhe jo siç rezulton të ketë ndodhur në rastin që po analizojmë, ku nëpunësi Gjeri Duro, është ngarkuar të kryejë dy funksione për një periudhë relativisht të gjatë nga data 05.08.2020 deri në 07.10.2022.

Duke qenë se, akti administrativ nr. 54, datë 05.08.2020, “*Për caktimin e një nëpunësi për ushtrim të përkohshëm të funksioneve*”, ka dalë në shkelje të hapur të ligjit, referuar nenit 109, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, ky akt është i paligjshëm.

Në këtë moment, çështja që shtrohet për shqyrtim është, nëse do të mund të ishte përgjegjës për shkelje shumë të rëndë të detyrave që lidhen me një funksion më të lartë, nëpunësi i vendosur të kryej këtë funksion në mënyrë të paligjshme dhe që nuk zotëron nivelin drejtues administrativ (që nënkupton edhe nivelin e njohurive dhe aftësitë e tij të pa provuara nëpërmjet konkurrimit) të kërkuar nga ligji?

Vendosja e një nëpunësi që të kryejë njëkohësisht dy funksione dhe për një periudhë relativisht të gjatë është një tjetër shkelje ligjore që evidentohet të jetë lejuar nga titullari i institucionit në këtë rast, pasi ligji për nëpunësin civil, ka përcaktuar në mënyrë shteruese se si plotësohen pozicionet e punës në shërbimin civil dhe në asnjë moment nuk është lejuar plotësimi i pozicionit të lirë nëpërmjet caktimit të përkohshëm të detyrave nga një nëpunës brenda institucionit, pasi për nëpunësin do të ishte e pamundur që të kryente dy funksione njëherësh.

Neni 26, i ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar, përcakton mënyrën e plotësimit të vendeve të lira në kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese si më poshtë:

1. “*Plotësimi i vendeve të lira në kategorinë e ulët ose të mesme drejtuese bëhet, së pari, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe, në rast të mosplotësimit të vendit të lirë, me procedurën e ngritjes në detyrë.*”

2. *Këto procedura organizohen nga njësia përgjegjëse, për një ose disa pozicione të lira të ngjashme, bazuar në parimin e përmendur në nenin 20 të këtij ligji.*
3. *Mund të aplikojnë për procedurat, sipas pikës 1 të këtij neni:*
 - a) *nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për vendin/vendet e lira nëpërmjet lëvizjes paralele;*
 - b) *nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse, të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, nëse plotësojnë kushtet dhe kërkesat e veçanta për vendin/vendet e lira, nëpërmjet ngritjes në detyrë.*

...
8. ***Nëse vendi i lirë nuk plotësohet nëpërmjet procedurës së parashikuar në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni, nëse është e nevojshme, mund të zbatohet procedura e transferimit të përkohshëm në interes të institucionit, sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 48 të këtij ligji”.***

Në rastin që po trajtojmë, nuk ndodhemi në kushtet kur institucioni ka zbatuar këtë dispozitë ligjore, por kur në mënyrë të kundërligjshme, është caktuar një nëpunës të kryejë dy funksione njëherësh, e për më tepër duke mos e testuar në mënyrën e kërkuar prej ligjit, nivelin e njohurive të tij, për të vlerësuar nëse ai e ka të mundur të realizojë me sukses detyrën e ngarkuar.

Vlen të theksohet që kjo shkelje e hapur e ligjit është lejuar për plotësimin e pozicionit më të rëndësishëm të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, atë të Drejtorit të saj, i cili referuar akteve ligjore e nënligjore, por edhe Rregullores së institucionit kryen detyra shumë të rëndësishme. Në këtë rast është cenuar një nga parimet e rëndësishme të shërbimit civil, që është respektimi i hierarkisë administrative në njësitë organizative të strukturës së institucionit, pasi punonjësi në fjalë, shfaqet edhe si epror *de facto* i eprorit ligjor të tij (Drejtorit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj). Ky i fundit, duhet të raportontë përpara vartësit të tij, gjë që përbën një absurditet në mënyrën e menaxhimit të burimeve njerëzore, e sidomos të shërbimit civil, në një institucion të administratës shtetërore.

Sa i përket procedurës disiplinore, Komisioneri çmon të trajtojë fillimisht kuadrin ligjor që rregullon këtë aspekt të administrimit të shërbimit civil, e më tej të vlerësojë pretendimet e ngritura nga nëpunësi për parregullsi në veprimet administrative që materializojnë këtë proces, në raport me aktet administrative që i janë vënë në dispozicion si nga institucioni, ashtu edhe nga nëpunësi.

Instituti i disiplinës në shërbimin civil është rregulluar nga Kreu X, i ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nga VKM-ja nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbim civil”, si dhe nga udhëzimi nr.1, datë 02.04.2014, “Për elementët kryesore proceduralë dhe materialë të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore” të Departamentit të Administratës Publike,

Referuar akteve administrative të vëna në administrim nga DPT, përmes të cilëve është materializuar procedura disiplinore në ngarkim të nëpunësit *****, Komisioneri ka konstatuar shkelje të ligjit gjatë zhvillimit të këtij procesi të cilat do të analizohen më poshtë.

➤ ***Komisioni Disiplinor nuk është krijuar sipas parashikimeve ligjore.***

Nëpunësi ***** është emëruar në pozicionin “Përgjegjës në Sektorin e Kontrollit në Vend sipas Industrive, në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj, në Drejtorinë Rajonale Tiranë” dhe gjatë gjithë periudhës së punësimit është paguar sipas pozicionit të tij të punës.

Nëse për këtë nëpunës do të ngrihej një Komision Disiplinor, referuar Kreut I, të VKM nr. 115, datë 05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbim civil”, duke qenë se ky nëpunës bën pjesë në një institucion të administratës shtetërore, atëherë KD do të përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë me përbërje:

- a) nëpunësin më të lartë civil të institucionit ku punon nëpunësi për të cilin ka nisur ecuria disiplinore, i cili kryeson komisionin;
- b) eprorin direkt të nëpunësit civil për të cilin ka nisur ecuria disiplinore;
- c) drejtuesin e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit ku bën pjesë nëpunësi për të cilin ka nisur ecuria disiplinore;
- ç) një përfaqësues të DAP-it;
- d) nëpunësin më të vjetër civil të institucionit ku punon nëpunësi për të cilin ka nisur ecuria disiplinore.”

Në urdhrin nr. 17926 prot., datë 19.10.2022, “Për ngritjen e Komisionit Disiplinor”, është caktuar në rolin e eprorit direkt të nëpunësit civil, Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, ndërkohë që nëpunësi ***** mbante pozicionin e “Përgjegjës të Sektorit”, fakt i cili është evidentuar në të gjitha aktet administrative, si dhe në vendimin përfundimtar të KD.

Referuar dispozitës së sipërcituar, epror direkt i nëpunësit në procedim është Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor dhe jo Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, i cili është ngarkuar me këtë atribut në rastin konkret.

Në këto rrethana, mosrespektimi i aktit nënligjor në fjalë, sa i takon mënyrës së ndërtimit të KD, nga ana e drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, në nxjerrjen e urdhrit nr. 17926 prot., datë 19.10.2022, *“Për ngritjen e Komisionit Disiplinor”*, e bën këtë akt të paligjshëm, e për rrjedhojë edhe KD-në, si produkt i tij, si një organ jo të ligjshëm për të shqyrtuar rastin dhe për të marrë vendim.

Në pikën 1, të urdhrit nr. 17926 prot., datë 19.10.2022, *“Për ngritjen e Komisionit Disiplinor”*, nga Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore, është urdhëruar:

*“Ngritja e Komisionit Disiplinor në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për zhvillimin e seancës dëgjimore e planifikuar në datën 27.10.2022, ora 10:00, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Komisioni do të zhvillojë mbledhjen e tij me nëpunës të Drejtorisë së Tatimpaguesve të mëdhenj *****, si dhe për shqyrtimin e çështjeve të tjera në procedim disiplinor të shtyra nga mbledhjet e kaluara të Komisionit të Disiplinës”.*

Referuar akteve ligjore të cituara edhe më sipër dhe në veçanti, pikës II, germa “A” të udhëzimit nr.1, datë 02.04.2014, *“Për elementët kryesore proceduriale dhe materiale të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”* të Departamentit të Administratës Publike, kompetencat e KD-së janë:

“Komisioni shqyrton dhe zgjidh ankesat për shkelje të pretenduara, të klasifikuara të rënda dhe shumë të rënda, të kryera me faj, nga nëpunësi civil.

Komisioni merr vendime për:

a) Fillimin e procedimit disiplinor.

b) Kryerjen e veprimeve të nevojshme hetimore me qëllim realizimin e një hetimi të plotë administrativ dhe të gjithanshëm sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative dhe pikës 14 të VKM nr.115, datë 05.03.2014.
...”.

Në rastin konkret, Drejtori i Përgjithshëm, nëpërmjet urdhrit nr. 17926 prot., datë 19.10.2022, ka ngritur KD dhe e urdhëron atë të zhvillojë seancë dëgjimore, ndërkohë që KD akoma nuk është formuar, nuk është njohur me kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor dhe aktet që provojnë shkeljet e pretenduara, si dhe nuk ka marrë ende një vendim nëse duhet të fillojë apo jo procedimin disiplinor ndaj nëpunësit *****.

Në vijim të kësaj analize, seanca dëgjimore caktohet pasi janë ndërrmarrë disa veprime administrative të tilla si: - është vendosur nga KD fillimi i procesit disiplinor ndaj nëpunësit që pretendohet se ka kryer shkelje të rëndë ose shumë të rëndë të detyrës; -është njoftuar nëpunësi për fillimin e ecurisë disiplinore; - i janë komunikuar nëpunësit të gjitha aktet që përmban dosja e procedimit disiplinor; - i është lënë koha e nevojshme nëpunësit për t'u mbrojtur dhe për t'u përfaqësuar me avokat.

➤ ***Mungon vendimi i KD për fillimin e procedimit disiplinor ndaj nëpunësit
*****.***

Rezulton se, pas urdhrorit për ngritjen e KD, ka dalë akti nr. 16895/3 prot., datë 21.10.2022, i Komisionit Disiplinor përmes të cilit është njoftuar nëpunësi për fillimin e ecurisë disiplinore. Referuar dokumentacionit të dërguar nga institucioni **nuk rezulton që KD të ketë marrë një vendim për fillimin e procedimit disiplinor** duke shkelur në këtë mënyrë dispozitën e sipërcituar.

➤ ***Mungon procesverbali i datës 27.10.2022***

Në aktin e njoftimit të nëpunësit të proceduar, për fillimin e ecurisë disiplinore, është caktuar seanca dëgjimore në datën 27.10.2022, mirëpo referuar dokumentacionit të administruar nga institucioni rezulton se, **kjo seancë nuk është zhvilluar** dhe se nga ana e KD nuk është mbajtur një procesverbal, ku të sqaroheshin arsyet e moszhvillimit të saj dhe vendimi për shtytjen e procesit, duke caktuar një ditë tjetër për seancën e rradhës.

➤ ***Nuk është respektuar faza procedurale që kërkon relatimin e çështjes nga ana e eprorit direkt gjatë seancës së parë dëgjimore***

Referuar procesverbalit të seancës së parë dëgjimore, atë të datës 03.11.2022, **eprori direkt nuk e ka relatuar çështjen**, ashtu siç përcaktohet në udhëzimit nr.1, datë 02.04.2014, “Për elementët kryesore proceduralë dhe materialë të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”, të Departamentit të Administratës Publike, por pasi është verifikuar prezenca e palëve në proces, është vijuar direkt me pyetje ndaj nëpunësit në procedim.

➤ ***Seancat dëgjimore nuk janë zhvilluar sipas procedurës së përcaktuar në udhëzimin e sipërcituar, e për pasojë edhe procesverbalet janë mbajtur duke mos respektuar elementët që duhet të përmbajë procesverbali.***

Referuar përmbajtjes së procesverbaleve gjatë zhvillimit të seancave, **konstatohet se nuk është respektuar procedura ligjore.** Në rastet kur KD ka marrë një vendim ai nuk është pasqyruar sipas kërkesave të udhëzimit në procesverbal.

Më konkretisht, procesverbali duhet të pasqyrojë me vërtetësi të gjitha veprimet e kryera nga KD dhe nga përmbajtja e procesverbaleve të hartuara gjatë procesit disiplinor, nuk rezultojn të jenë kryer veprimet si më poshtë:

- Nuk i është bërë e njohur subjektit të procedimit e drejta për kërkesa paraprake, ç`ka pasqyrohet në faktin se nuk i është drejtuar pyetja nëse ka ose jo kërkesa paraprake. *(Kërkesat paraprake, më tej vlerësohen nga KD, e cila shprehet me vendim të ndërmjetëm të argumentuar dhe të përcaktuar në afat kohor, vendim i cili pasqyrohet në procesverbal).*
- Mungon vendimi i ndërmjetëm i KD, duke marrë edhe mendimin paraprak të nëpunësit në procedim, për të kaluar në shqyrtimin e provave dhe fakteve.
- Në procesverbal nuk janë saktësuar vendimet që janë marrë në mbledhje, argumentet për vendimmarrjen, afatet e përcaktuara në vendimmarrje; - Formën e votimit *(i hapur apo i fshehtë)* dhe rezultatin e tij, pra nëse ka patur vota kundër.

Sa sipër, nga ana e KD dhe e Sekretariatit Teknik, nuk është respektuar procedura për zhvillimin e seancave për shqyrtimin e çështjes.

➤ **Konstatohet tejkalim i afatit për shqyrtimin e një procedimi disiplinor.**

Referuar akteve të administruara në këtë proces konstatohet se, procedimi disiplinor në ngarkim të nëpunësit ***** ka filluar me aktin nr.746/10 prot., datë 06.10.2022, *“Mbi fillimin e ecurisë disiplinore”* dhe Komisioni Disiplinor ka nisur procesin menjëherë pas ngritjes së tij, përmes urdhrin nr.17926 prot., datë 19.10.2022. Rezultojn se ecuria disiplinore ka përfunduar me Vendimin përfundimtar nr.129, datë 13.03.2024, pra, **ky proces ka zgjatur rreth një vit e pesë muaj.**

Lidhur me respektimin e afatit për përfundimin e procesit disiplinor, Komisioneri vlerëson të marrë në analizë dispozitat e mëposhtme:

- Pika 11, e VKM-së nr. 115, datë 05.03.2014 *“Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbim civil”*, përcakton se:

“Në rast se eprori direkt vihet në dijeni për një shkelje disiplinore nga subjektet e përcaktuara në shkronjën “b” të pikës 4 të nenit 59 të ligjit nr. 152/2013, eprori direkt fillon menjëherë ecurinë disiplinore ose, nëse nuk është kompetent për shqyrtimin e saj, ia përcjell informacionin KD-së”

- Në pikën II/A të udhëzimit nr.1, datë 02.04.2014, “Për elementët kryesore proceduralë dhe materialë të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore” të Departamentit të Administratës Publike, është parashikuar se:

A. “Kompetencat, organizimi dhe funksionimi i KD

Komisioni shqyrton dhe zgjidh ankesat për shkelje të pretenduara, të klasifikuara të rënda dhe shumë të rënda, të kryera me faj, nga nëpunësi civil.

Komisioni merr vendime për:

a) Fillimin e procedimit disiplinor.

b) Kryerjen e veprimeve të nevojshme hetimore me qëllim realizimin e një hetimi të plotë administrativ dhe të gjithanshëm sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative dhe pikës 14 të VKM nr.115, datë 05.03.2014”.

- Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, i vendosur si referim në dispozitën e mësipërme, parashikon:

Neni 53. Përcaktimi dhe shtyrja e afateve procedurale

- 1. Afatet për kryerjen e një veprimi procedural nga palët, të quajtura në vazhdim “afatet procedurale”, përcaktohen nga ligji ose aktet nënligjore.*
- 2. Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Kod, nëse ligji ose aktet nënligjore nuk parashikojnë një afat të caktuar për kryerjen e një veprimi procedural, organi publik që kryen procedurën cakton me vendim të veçantë një afat të arsyeshëm, sipas çështjes konkrete dhe në përputhje me parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit.*
- 3. Afati procedural i caktuar nga ligji ose aktet nënligjore mund të zgjatet vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht nga ligji ose akti nënligjor, ndërsa afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit.*

Neni 91. Afati për përfundimin e procedurës administrative

- 1. Procedura administrative, e nisur me kërkesë, me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në këtë Kod, përfundon sa më shpejt të jetë e mundur dhe brenda afatit të përcaktuar nga ligji i posaçëm.*
- 2. Në mungesë të afateve të përcaktuara nga ligji i posaçëm, afati për përfundimin e procedurës administrative është 60 ditë.*
- 3.”*

Neni 92 Zgjatja e afatit të procedurës

1. Përveç kur ndalohet shprehimisht nga ligji, në raste të justifikuara, për shkak të kompleksitetit të çështjes, organi publik **mund të zgjasë vetëm një herë afatin e përcaktuar sipas nenit 91 të këtij Kodi.**
2. Zgjatja e afatit bëhet për aq sa është e nevojshme për përfundimin e procedurës, në proporcion me vështirësinë e çështjes konkrete, **por jo më shumë se kohëzgjatja e afatit fillestar.**
3. Zgjatja e afatit dhe data e përfundimit të afatit të zgjatur i njoftohen palës brenda afatit fillestar. Njoftimi duhet të përmbajë edhe arsyetimin për zgjatjen e afatit.

Aktet ligjore dhe nënligjore për shërbimin civil nuk kanë përcaktuar një afat brenda të cilit KD duhet të përmbyllë procedurën disiplinore, por kanë përcaktuar që, KD duhet të kryej veprimet e nevojshme hetimore me qëllim realizimin e një hetimi të plotë administrativ dhe të gjithanshëm sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative dhe pikës 14 të VKM nr.115, datë 05.03.2014’.

Neni 53, i Kodit të Procedurave Administrative ka sanksionuar në pikën dy të tij se, nëse ligji ose aktet nënligjore nuk parashikojnë një afat të caktuar për kryerjen e një veprimi procedural, organi publik që kryen procedurën cakton me vendim të veçantë një afat të arsyeshëm, sipas çështjes konkrete dhe në përputhje me parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit.

Në rastin që po analizojmë, rezulton se KD nuk ka marrë një vendim të veçantë për të përcaktuar një afat të arsyeshëm për përfundimin e procesit. Duke qenë se KD nuk e ka përcaktuar afatin për përfundimin e procedurës disiplinore, jemi përpara rastit të parashikuar nga neni 91, i Kodit të Procedurave Administrative, ku është sanksionuar se, procedura administrative, e nisur me kërkesë, përfundon sa më shpejt të jetë e mundur dhe në mungesë të afateve të përcaktuara nga ligji i posaçëm, afati për përfundimin e procedurës administrative është 60 ditë.

Referuar nenit 92, të Kodit të Procedurave Administrative, organi publik mund të zgjasë **vetëm një herë afatin** e përcaktuar sipas nenit 91 dhe zgjatja e afatit bëhet për aq sa është e nevojshme për përfundimin e procedurës, në proporcion me vështirësinë e çështjes konkrete, **por jo më shumë se kohëzgjatja e afatit fillestar.**

Në këto kushte, në analizë të normave ligjore të sipërcituara KD **nuk ka respektuar dispozitat ligjore gjatë zhvillimit të ecurisë disiplinore**, të cilat sanksionojnë afatin brenda të cilit duhet të përfundojë procesit, pasi e ka zgjatur hetimin administrativ për 1 vit e 5 muaj, ndërkohë që ka detyrimin ligjor për ta përmbyllur brenda 60 ditëve. Vetëm në

raste të veçanta kur ekzistojnë shkaqe të justifikuara, KD me vendim të arsyetuar, mund ta zgjasë afatin jo më shumë se 60 ditë të tjera.

Sa sipër, Komisioneri vlerëson se, procedura disiplinore nuk mund të zgjatet më shumë se 120 ditë (katër muaj) nga momenti i fillimit të saj, referuar afateve të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative.

Rezulton se, nëpërmjet Vendimit nr. 430, datë 13.12.2022, KD ka pezulluar procedurën administrative për ecurinë disiplinore në ngarkim të nëpunësit ***** deri në përfundim të hetimit nga Drejtoria e Investigimit të Brendshëm Antikorrupsion në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, hetim të cilin ia kishte ngarkuar kësaj njësie, në seancën dëgjimore të datës 03.11.2022, pra duke mos vendosur një afat konkret.

Në këtë rast, edhe nëse nuk do të analizonim ligjshmërinë e këtij vendimi, pra nëse mund t'i delegojë KD kompetencat e hetimit administrativ tek një njësi tjetër, përsëri, ky delegim nga njëra anë nuk mund të bëhet pa afat, si dhe nga ana tjetër, njësia që i është deleguar hetimi administrativ duhet ta përfundojë atë duke respektuar afatet ligjore që parashikohen në Kodin e Procedurave Administrative, pasi në të kundërt, shkelet haptazi procedura e përcaktuar në ligj.

Në lidhje me këtë aspekt, nëpunësi civil gëzon garancitë procedurale për të patur një procedim të drejtë, sipas afateve të parashikuara në ligj, me qëllim që të mos ngelë nën tryshninë e një mjeti ndëshkues, tej afateve ligjore, ç'ka ndikon negativisht në dëm të të drejtave dhe sigurisë së tij juridike si edhe në dëm të performancës së tij në punë. Në rastin konkret, Komisioneri vlerëson se, nga ana e KD janë shkelur afatet për përfundimin e procedimit disiplinor në ngarkim të nëpunësit *****.

➤ **Vendimi i ndërmjetëm nr. 430, datë 13.12.2022, i KD është një vendim i paligjshëm, pasi është nxjerrë në kapërcim të kompetencave të tij.**

Në rastin që po trajtojmë, KD nëpërmjet Vendimit të ndërmjetëm nr.430, datë 13.12.2022, ka pezulluar procedurën disiplinore në ngarkim të nëpunësit ***** deri në përfundimin e hetimit nga Drejtoria e Investigimit të Brendshëm Antikorrupsion në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

Në përmbajtje të këtij vendimi është arsyetuar se:

“Në seancën e zhvilluar në datën 03.11.2022, Komisioni Disiplinor kërkoi që të kryhet një investigim dhe hetim më i gjerë për sqarimin e plotë të situatës, hetim për të cilin është ngarkuar Drejtoria e Investigimit të Brendshëm Antikorrupsion në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

Bazuar në provat e administruara në dosje dhe mbështetur në faktin se përfundimi i kësaj procedure është e lidhur ngushtë me hetimin dhe investigimin që po kryen Drejtoria e Investigimit të Brendshëm Antikorrupsion, Komisioni i Disiplinës që zhvillon procedurën administrative arsyeton që të ndërmerret një vendim i ndërmjetëm siç është vendimi për pezullimin e procedurës së vendimmarrjes, për shkak të kompletitetit të çështjes dhe për verifikimin dhe hetimin e mëtejshëm të çështjes, shqyrtimin e provave dhe materialeve të parashtruara, deri në përfundimin e investigimit që po kryen Drejtoria e Investigimit të Brendshëm Antikorrupsion”.

Duke analizuar këtë akt administrativ, vlerësojmë se në marrjen e vendimit nr. 430, datë 13.12.2022, KD nuk ka respektuar disa dispozita të akteve nënligjore dhe rregullative, ndër të cilat:

- Pikën 14, të VKM nr. 115, datë 5.3.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” e cila sanksionon:

“Organi disiplinor heton kryesisht të gjitha faktet dhe vlerëson të gjitha rrethanat e ngjarjes që janë të nevojshme për marrjen e vendimit, si dhe mund të përdorë çdo mjet për të mbledhur prova, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative, e, në veçanti, ai kryen veprimet e mëposhtme:

- a) pyet ose merr deklaratat nga dëshmitarët dhe verifikon faktet kundërshtuese;
 - b) rishikon dokumentacionin përkatës për mospërputhje, për fakte që mungojnë, data apo firma që janë hequr etj.;
 - c) shqyrton dosjen e nëpunësit;
 - ç) thërret nëpunësin për t’u njohur me variantin e tij të ngjarjeve apo të problemit;
 - d) verifikon praktikën dhe rastet e procedimeve disiplinore të mëparshme;
 - e) kryen çdo veprim tjetër të nevojshëm për verifikimin e ngjarjes”.
- pikën II/A të udhëzimit nr.1, datë 02.04.2014, “Për elementët kryesore proceduriale dhe materiale të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore” të Departamentit të Administratës Publike, është parashikuar se:

A. “Kompetencat, organizimi dhe funksionimi i KD

Komisioni shqyrton dhe zgjidh ankesat për shkelje të pretenduara, të klasifikuara të rënda dhe shumë të rënda, të kryera me faj, nga nëpunësi civil.

Komisioni merr vendime për:

- a) Fillimin e procedimit disiplinor.
- b) **Kryerjen e veprimeve të nevojshme hetimore me qëllim realizimin e një hetimi të plotë administrativ dhe të gjithanshëm sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative dhe pikës 14, të VKM nr.115, datë 05.03.2014”**

Sa më sipër, në kundërshtim me përcaktimet e dispozitave këtyre dispozitave, Komisioni Disiplinor nuk ka realizuar kompetencën e tij, nëpërmjet një hetimi të plotë administrativ, ashtu si e ngarkon ligji, por e ka deleguar këtë detyrim të tijin, tek një njësi tjetër hetimi, që është Drejtoria e Investigimit të Brendshëm Antikorrupsion.

Konstatohet se, ky delegim bie ndesh edhe me nenin 22, të Kodit të Procedurave Administrative, i cili ka përcaktuar lidhur me juridiksionin dhe kompetencën e organit publik si më poshtë:

1. Fusha e ushtrimit të veprimtarisë dhe tërësia e kompetencave të organeve publike, të rregulluara nga legjislacioni në fuqi, përbën juridiksionin administrativ.
2. Kompetencat e organeve publike janë të përcaktuara me ligj, me akt nënligjor, si dhe veprimet administrative të nxjerra në zbatim të tyre. **Ushtrimi i tyre është i detyrueshëm.**
3. Delegimi ose zëvendësimi i kompetencave mund të bëhet vetëm nëse:
 - a) parashikohet shprehimisht në ligj;
 - b) ligji parashikon organin ose nëpunësin zëvendësues ku bëhet delegimi ose zëvendësimi.

Referuar kësaj dispozite ligjore, KD legjitimohej të ngarkonte Drejtorinë e Investigimit të Brendshëm Antikorrupsion që të kryente hetimin administrativ vetëm në rast se: - delegimi ishte parashikuar shprehimisht në ligj; si dhe - ligji e kishte përcaktuar këtë njësi si organ zëvendësues / apo KD lejohej që t'i delegonte kompetenca atij.

Referuar akteve ligjore dhe nënligjore të cilat rregullojnë institutin e disiplinës në shërbimin civil, nuk rezulton që të jetë përcaktuar ndonjë organ që të zëvendësojë veprimtarinë e KD apo t'i lejojë këtij organi mundësinë e delegimit të kompetencave.

Sipas pikës 2, të nenit 22, të Kodit të Procedurave Administrative, ushtrimi i kompetencave nga organi publik është i detyrueshëm dhe në këto kushte, KD kishte detyrimin ligjor që të kryente vetë një hetim administrativ të plotë, pasi të gjithë anëtarët e saj janë kompetentë për të trajtuar çdo problematikë që ka lidhje me punonjësin në procedim, ndërsa në këtë rast, KD në shkelje të hapur të ligjit, e ka deleguar këtë kompetencë tek një organ tjetër.

- **KD gjatë zhvillimit të procedurës disiplinore, në mungesë të kompetencës, ka shtuar objektin e ecurisë disiplinore.**

Rezulton se, gjatë zhvillimit të procedimit disiplinor Komisioni Disiplinor ka shtuar objektin e procedimit duke propozuar një kontroll mbi veprimtarinë e nëpunësit *Gj. Duro (në cilësinë e Drejtorit Rajonal)* për një periudhë tjetër dhe veprime të ndryshme nga ato të

kontrolluar prej KLSH, që ka qenë edhe motivacioni për fillimin e procedimit, duke shtuar në këtë mënyrë objektin e ecurisë disiplinore.

Në pikat 13 e vijues, të VKM nr. 115, datë 5.3.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, dhe pikës II/A të udhëzimi nr.1, datë 02.04.2014, “Për elementët kryesore procedurialë dhe materialë të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore” të Departamentit të Administratës Publike, janë parashikuar kompetencat dhe të gjitha veprimet administrative që kryen KD gjatë një ecurie disiplinore.

Referuar këtyre akteve nënligjore, KD shqyrton dhe zgjidh ankesat për shkelje të pretenduara, të klasifikuara të rënda dhe shumë të rënda, të kryera me faj, nga nëpunësi civil dhe nuk është përcaktuar ndonjë kompetencë për të shtuar objektin e ecurisë disiplinore.

Duke u kthyer në rastin konkret, KD në mungesë të kompetencës ka shtuar objektin e ecurisë disiplinore ndaj nëpunësit në procedim, si dhe në shkelje të hapur të ligjit i'a ka deleguar hetimin administrativ një njësie tjetër organizative në institucion. Për shkak të këtyre veprimeve administrative vendimi e ndërmjetëm nr. 430, datë 13.12.2022, është një akt i nxjerrë në shkeje të hapur të ligjit.

Sa i përket themelit të çështjes, referuar përmbajtjes së vendimit përfundimtar, por edhe përmbajtjes së procesverbaleve të seancave dëgjimore, Komisioneri vëren se, KD është mjaftuar vetëm në referimin e dispozitave ligjore dhe nuk ka analizuar dhe sqaruar se cilat ishin veprimet apo mosveprimet konkrete të nëpunësit të kryera me faj.

Referuar nenit 60, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, i cili parashikon parimet për përshkallëzimin dhe individualizimin e masës disiplinore ku sanksionohet se:

“Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, eprori direkt ose komisioni disiplinor bazohet në:

- a) shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e ardhura prej saj;*
- b) shkallën e fajësisë;*
- c) ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashuara, sipas nenit 61 të këtij ligji”;*

si dhe pikës 19 germa “dh”, të VKM nr. 115/2014, ku parashikohet se:

“Vendimi përfundimtar i organit disiplinor përmban këto të dhëna:

.....

dh) arsyetimin e vendimit dhe shpjegimin e fakteve që janë bërë shkas për marrjen e vendimit”;

rezulton se, KD ka detyrimin ligjor që në përfundim të procedurës disiplinore të nxjerrë një vendim që të parashtojë në mënyrë të qartë arsyet e vendimmarrjes për çdo element të objektit.

Në rastin konkret, lidhur me pretendimet mbi parregullsitë gjatë procedurës së kontrollit për 9 subjekte, gjatë kohës që kërkuesi ka qenë Drejtor Rajonal i DRT Tiranë, nuk është arsyetuar dhe nuk janë evidentuar në asnjë moment se cila është lidhja organike apo funksionale ndërmjet parregullsive të pretenduara si të konstatuara dhe veprimeve apo mosveprimeve konkrete të nëpunësit civil. Nga përmbajtja e vendimit nuk rezulton të jetë kryer ndonjë vlerësim apo analizë e veprimeve apo mosveprimet konkrete të nëpunësit civil të kryera në faj dhe që bien ndesh me aktet ligjore apo nënligjore që kuadrojnë detyrat e tij funksionale dhe pasojat e ardhura prej tyre.

Në përfundim të sa u analizua më sipër, Komisioneri vlerëson se, KD gjatë zhvillimit të procedimit disiplinor ka kryer shkelje ligjore me karakter material dhe procedural në çdo fazë të procesit të zhvillimit të ecurisë disiplinore të cilat e kanë cënuar rëndë atë dhe referuar nenit 108, të Kodit të Procedurave Administrative, Vendimi nr.129, datë 13.03.2024, i Komisionit të Disiplinës është një akt absolutisht të pavlefshëm, i cili në bazë të nenit 110 dhe 111 të Kodit të Procedurave Administrative duhet të konstatohet si i tillë dhe të rregullohen pasojat nga organi që e ka nxjerrë.

Për këtë arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të Ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; të germës d) dhe dh), të nenit 108, të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar; si dhe në mbështetje të Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar,

VENDOSA:

Të paralajmërojë institucionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për rregullimin e situatës së ligjshmërisë, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, duke vepruar në këtë mënyrë:

1. Komisioni Disiplinor në bazë të neneve 108, 110 dhe 111, të Kodit të Procedurave Administrative të konstatojë pavlefshmërinë absolute të vendimit nr.129, datë 13.03.2024.

2. Drejtori i Përgjithshëm në bazë të neneve 108, 110 dhe 111, të Kodit të Procedurave Administrative të konstatojë pavlefshmerine absolute aktin administrativ nr. 2089/2 prot., datë 03.04.2024, për ndërprejen e marrëdhënieve financiare për Z. *****, i cili ka dalë në zbatim të një akti administrativ absolutisht të pavlefshëm që është Vendimi nr.129, datë 13.03.2024,” i KD, si dhe të rregullojë pasojat e ardhura.
3. Nëpunësi ***** të vijojë marrëdhëniet në shërbimin civil në pozicionin e punës “Përgjegjës Sektori i Kontrollit në Vend sipas Industrive, në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj, në Drejtorinë Rajonale Tiranë”, në të cilin ai është emëruar në përputhje me kërkesat e ligjit për nëpunësin civil.
4. Për kryerjen e këtij veprimi administrativ, lihet afat **10 ditë**, nga marrja dijani për këtë vendim.
5. Me kalimin e këtij afati, institucioni të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
6. Të njoftohet për këtë vendim Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Departamenti i Administratës Publike, si dhe nëpunësi *****.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha